



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija/Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Numër: 46/01B
Datë: 28/05/2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), si dhe nenit 30 shtojca nr. 7 e Rregullores (QRK) nr. 2/2021 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Për ndarje të bursave për nxënës në IAAP në drejtimet deficitare dhe bursa për vajza në drejtimet teknike

1. MASHTI dhe Projekti LuxDev KSV/020, ndajnë bursa për nxënësit e IAAP-ve për vitin shkollor 2021/2022.
2. Vlera e bursës për nxënës është 500 euro për vit shkollor.
3. Numri i bursave nga MASHTI është 40, ndërsa numri i bursave nga Projekti LuxDev KSV/020 është 50.
4. MASHTI ndan 20 bursa për nxënësit e IAAP-ve në drejtimet deficitare dhe 20 bursa për vajza në drejtimet teknike
5. Projekti LuxDev KSV/020 ndan 30 bursa për nxënësit e IAAP-ve në drejtimet deficitare dhe 20 bursa për vajza në drejtimet teknike.
6. Bursat për nxënës në drejtimet deficitare:
 - Metalpunues
 - Instalues elektrik
 - Instalues ujësjellësi, ngrohjes dhe klimatizimit
 - Teknologjia e riciklimit

- Zhvillues i aplikacioneve (TIK)
7. Bursat për vajza në drejtimet teknike:
- Teknik për dizajnin e mediave interaktive
 - Instalues elektrik
 - Veterinë
 - Mekatronikë
 - Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
 - Automekanikë
 - Kultivuesit hortikultural dhe të fidanishteve

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe me qëllim të përkrahjes së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Republikën e Kosovës, duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës, si dhe në mbështetje të kërkesave të IAAP-ve dhe në funksion të nxitjes së nxënësve për regjistrim në drejtimet deficitare dhe të vajzave në drejtimet teknike për vitin shkollor 2021 - 2022, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministres;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP);
4. DAAP;
5. LuxDev -KSV/020;
6. Departamentit ligjor;
7. Dep. të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
8. Arkivit të MASHTI

Arbërie Nagavci

Ministër e MASHTI

